



Republika e Kosovës \* Republic of Kosovo  
Komuna \* Municipality  
Hani i Elezit



DATE: 03.10.2024

NR.09/ SAD /2024

## KONTRATË PËR SHËRBIME

Numri i kontratës<sup>1</sup>: 659-24-8190-2-2-1/C564 & KKHE-24-039-2-2-1

KOMUNA HANI I ELEZIT (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

Sahadete Zharku Kalisi, rr. Arberia nr.6, Hani i Elezit, 1171002482, (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

Shërbime konsulente për IPA Fonde (Zyrtar i IT-se, Zyrtar i Financave dhe Zyrtar i Komunikimit) me numër identifikues: 659-24-8190-2-2-1

### Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit të Shërbimeve:

Shërbime konsulente Ekspert të fushave të ndryshme (Zyrtar i IT-se, Zyrtar i financave dhe Zyrtar i komunikimit)- projekti IPA Fonde

No.	Lot-2
2	Shërbime konsulente për IPA Fonde - Zyrtar i Financave

### Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: 9,840.00 €; [Nëntë mijë e tetëqindë e katerdhjetë Euro /zero zero cent ] Euro.Paga bruto

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

### Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- Marrëveshja e kontratës;
- Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);
- [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

<sup>1</sup> Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

**Neni 4****Komunikimet**

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Shqipe<sup>2</sup> në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.

**Për Autoritetin Kontraktues KOMUNA HANI I ELEZIT**

<b>Emri:</b>	Xhevdet Bushi
<b>Pozita:</b>	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	03.10.2024
<b>Vula:</b>	

**Për Ofruesin e Shërbimeve Sahadete Zharku Kalisi**

<b>Emri:</b>	Sahadete Zharku Kalisi
<b>Pozita:</b>	Zyrtare e Financave
<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	03.10.2024
<b>Vula:</b>	

<sup>2</sup> Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

# KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 659-24-8190-2-2-1/C564

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe.
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të Shërbimeve është: <b>tre (3) dite pas nenshkrimit te kontrates</b>
	6.4	Data e Përfundimit është <b>sipas marreveshjes se projektit 24 muaj nga momenti i nenshkrimit</b>
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është: <i>Komuna Hani i Elezit dhe sipas lokacioneve tjera te percaktuara nga projekti IPA Fondeve</i>
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është <b>Do te caktohet me vendim te veqant të ZKA-së.</b>
Dëmet e likuiduara	13.1	Norma e dëmeve të likuiduara është <i>0.5% per dite per sherbime te perealizuara</i> Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është <i>10% e vleres se kontrates të çmimit final të kontratës</i>
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është: <b>10% e vleres se kontrates me afat prej 25 mujave</b>
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve	15.1	N/A
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Orari i pagesës do të jetë: <b>Pagesa do te behet pas realizimit te sherbimit mujor</b> <b>Pagesa do te behet brenda afatit ligjor</b>
Kontrolli i kualitetit	17.1	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në vijim: <i>AK-respektivisht menaxheri i kontrates do te mbikqyr realizimin e sherbimit dhe do te njoftoj AK dhe menaxherin kryesor te ketij projekt-per ecurin e realizimit te sherbimi</i>
Përshkrimi i detyrave të punes	17.2	Zyrtari financiar -Zyrtari financiar do te jete i ngarkuar per kontabilitetin, menaxhimin e llogarise se projektit dhe pergatitjen e raporteve financiare (te perkohshme dhe perfundimtare), si dhe per te marr persiper mbeshtetjen dhe ndihmen e nevojshme per ekipin e auditimit. - Pergjegjes per zbatimin e pagesave financiare ne perputhje me linjat e buxhetit te projektit; - Pergjegjes per pergatitjen e raporteve financiare; - -Pergjegjes per ruajtjen e mardhenieve me organet qeveritare; Zyra e Taksave, Qendra kombetare e regjistrimit -Pergjegjes oer pergatitjen e raporteve financiare Pergjegjes per faturat e marra nga kontraktor dhe dokumente tjera financiare per projektin Si dhe detyra te caktuara nga menaxheri I projektit -Do te anagazhohet 30% te kohes se punes Brenda kohezgjatjes se projektit
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Zyra e Prokurimit – Komuna e Hanit te Elezit ose permes procedurave alternative te zgjidhje se mosmarrveshjeve-procedurat e ndermjetesimit me pajtimin e te dy palve
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata Komerciale / në pajtim me ligjin në Kosovë. b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].